

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE – NATYRORE
DEPARTAMENTI I MATEMATIKËS

DORACAK PËR STUDENTË

2022 – 2023



Informacioni që gjendet në këtë doracak është valid për vitin akademik 2022-2023.

Versioni i fundit këtij doracaku (v1) mund të gjendet në këtë adresë: <https://fshmn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,118>

Ky doracak është aprovuar për botim nga departamenti i matematikës në mbledhjen e dates 24.05.2022

Përpiluar dhe realizuar nga: Prof. Asoc. Dr. Ermir Rogova

PËRMBAJTJA

MESAZHI I MIRËSEARDHJES	4
HYRJE	5
RRETH INSTITUCIONIT	6
<i>UNIVERSITETI I PRISHTINËS</i>	6
VIZIONI	6
MISIONI	6
UEB-FAQJA	6
<i>FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE – NATYRORE</i>	7
UEB-FAQJA	7
DEPARTAMENTI I MATEMATIKËS	8
<i>MUNDËSI PËR NJË KARRIERË TË SUKSESSHME PROFESIONALE</i>	8
<i>LOKACIONI</i>	9
<i>HARTA E DEPARTAMENTIT</i>	10
<i>PERSONELI</i>	11
PROGRAMET E STUDIMIT	13
<i>BSc Matematikë</i>	13
<i>BSc Matematikë financiare në banka dhe sigurime</i>	15
<i>BSc Shkencë kompjuterike</i>	17
<i>MSc Matematikë</i>	19
<i>MSc Shkencë kompjuterike</i>	20
ORGANIZIMI I STUDIMEVE	21
<i>PRANIMI NË STUDIME</i>	21
<i>PROVIMI PRANUES</i>	21
<i>PËRCAKTIMI I SUKSESIT AKADEMIK</i>	22
<i>PËRMBUSHJA E OBLIGIMEVE DHE PARAQITJA E PROVIMEVE</i>	24
<i>PUNIMI I DIPLOMËS</i>	24
BAÇELLOR	24
MASTER	25
<i>VITI AKADEMIK</i>	27
<i>NDËRRIMI I DREJTIMIT TË STUDIMEVE</i>	27
BIBLIOGRAFIA	

MESAZHI I MIRËSEARDHJES

Të nderuar studentë,

Departamenti i Matematikës ka një traditë relativisht të gjatë. U themelua në vitin 1960, fillimisht në kuadër të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Beogradit, kurse 11 vite më vonë, me themelimin e Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Prishtinës, iu bashkëngjiti këtij fakulteti në kuadër të të cilit ndodhet edhe tash e 62 vite.

Gjatë këtyre viteve në Departamentin e Matematikës diplomuan shumë studentë, të cilët sot gjenden në institucione të ndryshme si në shkolla fillore e të mesme, universitete, banka, kompani të ndryshme softuerike, si dhe vende tjera ku kërkohen njohuri të avancuara për matematikën dhe zbatimet e saj.

Departamenti i Matematikës sot ka këto programe aktive: Programin matematikë në baçelor dhe master, programin në shkencë kompjuterike në baçelor dhe programin e matematikës financiare në banka e sigurime në baçelor. Po ashtu, në procedurë të akreditimit janë programet e reja për master në matematikë me zbatime dhe shkencë kompjuterike. Së shpejti planifikohet të rihapen edhe studimet e doktoratës.

Duke u bazuar në kërkesat e tregut të punës, zgjedhja eventuale për studim në departamentin tonë do të iu ndihmonte shumë që të keni mundësi të mira për avancim shkencor, gjetjen e lehtë të një vendi të punës apo rekrutim si staf i ri në Departament.

Ky doracak, pikërisht iu është dedikuar nxënësve që kanë përfunduar shkollën e mesme të lartë dhe do të ju shërbej si lehtësues për marrjen e vendimit për regjistrim në studime.

Me respekt,

Prof. Ass. Dr. Elver Bajrami,
Shefi i Departamenti të Matematikës.

HYRJE

Ky doracak, i cili është përpiluar për nevojat e studentëve të departamentit të matematikës, jep njoftime dhe shpjegime lidhur me rregullat, politikat, procedurat e universitetit dhe fakultetit si dhe të drejtat dhe obligimet e studentëve. Qëllimi i tij është të shërbejë si udhërrëfyes për studentët aktual dhe për studentët e ardhshëm.

Materiali i përdorur në këtë doracak përbëhet prej pjesëve të zgjedhura nga dokumentet e publikuara në seksionin e bibliografisë. Nëse ndonjë çështje nuk është qartësuar sa duhet, apo ju nevojiten më shumë detaje, atëherë ju rekomandohet të shfletoni dokumentet bazë të cilat në bibliografi ekzistojnë si vegëza (aty ku ka mundësi). Nëse doracaku bie ndesh me dokumentet zyrtare të publikuara nga universiteti, atëherë përparësi kanë dokumentet zyrtare.

Në doracak po ashtu do të gjeni informacione lidhur me programet studimore, personelin akademik dhe mbështetës si dhe hapësirat në kuadër të departamentit të matematikës.

Ky doracak aplikohet për vitin akademik 2022-2023 dhe si i tillë do të azhurnohet çdo vit. Versioni i fundit i tij gjendet në adresën: <https://fshmn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,118>

RRETH INSTITUCIONIT



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Universiteti i Prishtinës është themeluar me Ligjin mbi Themelimin e Universitetit të Prishtinës, të cilin e miratoi Kuvendi i Krahinës Socialiste të Kosovës, më 18 nëntor 1969. Themelimi i Universitetit të Prishtinës ishte ngjarje historike për popullin e Kosovës, si edhe për mbarë kombin shqiptar. Kuvendi themelues i Universitetit të Prishtinës u mbajt më 13 shkurt 1970, kurse dy ditë më vonë, më 15 shkurt 1970, u mbajt edhe mbledhja solemne e Kuvendit dhe pikërisht kjo datë u shpall Dita e Universitetit të Prishtinës.

VIZIONI

Universiteti i Prishtinës është një institucion i arsimit të lartë, i njohur globalisht për profesionalizëm, integritet, mësimdhënie cilësore dhe hulumtim. Në harmonizim me nevojat e ekonomisë dhe të tregut, do të vendosë dhe mirëmbajë standarde të cilësisë, duke përkrahur mobilitetin dhe zhvillimin e karrierave akademike për personelin dhe studentët, duke e rritur numrin e partnerëve dhe duke iu bashkuar rrjetit të edukimit të lartë evropian.

MISIONI

Misioni i UP-së bazohet në zhvillimin akademik, hulumtimet shkencore, artistike dhe sigurimin e arsimit të lartë përmes programeve me interes strategjik dhe zhvillimor të Republikës së Kosovës. Universiteti mundëson mobilitetin e programeve, studentëve dhe stafit akademik në vazhdimësi, me qëllim të arritjes së nivelit ndërkombëtar dhe konkurrencës në treg.

Misioni i universitetit bazohet në aspiratat e qytetarëve të vendit përmes sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, zhvillimin akademik, shkencor, artistik apo edhe disiplinave me interes kombëtar për Republikën e Kosovës.

UEB-FAQJA

<http://www.uni-pr.edu>

FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE – NATYRORE



Figura 1 -Pamja nga rruga Eqrem Çabej

Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) në Prishtinë është themeluar në vitin 1971. Studimet e shkencave të natyrës dhe matematikës (kimi, biologji, fizikë dhe matematikë) kanë filluar njëmbëdhjetë vjet më herët në kuadër të Fakultetit Filozofik, të themeluar në vitin 1960.

Në vitin 1971 nga ky fakultet ndahet seksioni i shkencave ekzakte dhe prej tij formohet Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, në të cilin organizohen studime të rregullta dhe me korrespondencë në pesë departamente: kimi, biologji, fizikë, gjeografi dhe matematikë. Këto departamente funksionojnë edhe sot.

UEB-FAQJA

<http://fshmn.uni-pr.edu>

DEPARTAMENTI I MATEMATIKËS

MUNDËSI PËR NJË KARRIERË TË SUKSESSHME PROFESIONALE

Studentët e diplomuar në Departamentin tonë kanë treguar suksese në profesione të ndryshme. Një numër syresh janë orientuar në karrierë akademike, në matematikë, shkencë kompjuterike apo matematikë financiare, dhe ata tashmë janë të punësuar në UP, në universitete të tjera në Kosovë dhe në shumë vende të botës. Disa prej tyre janë mësimdhënës në arsimin para universitar.

Po ashtu, një numër i të diplomuarve, sidomos të programit të shkencës kompjuterike dhe të matematikës financiare, por edhe të matematikës, janë orientuar përherë e më shumë edhe në sektorin privat ose në institucione të tjera. Kompetencat dhe përvojat e fituara gjatë studimeve në Departament janë tejet atraktive për ndërmarrje dhe institucione ku përdoren aftësi kuantitative dhe të menduar kritik, të cilat zhvillohen në programet tona.

Departamenti ynë është dinamik dhe në vazhdimësi adaptohet me nevojat e tregut të punës, duke prodhuar kuadro që shquhen në Kosovë dhe më gjerë.

LOKACIONI




Figura 2 - Pozita në Google maps

Departamenti i matematikës është i vendosur në katin II të ndërtesës së fakultetit të shkencave matematike – natyrore (pjesa në hartë e ngjyrosur me ngjyrë të kuqe). Përjashtimisht, zyrat e shërbimit për studentë (referentët) dhe kabineti 9 gjenden në katin përdhësë në anën e majtë të hyrjeve, si dhe kabineti P7 i cili gjendet në nivelin e podrumit për afërsisht nën sallën 114.

HARTA E DEPARTAMENTIT




Figura 3 - Harta e departamentit¹

¹ Vetëm për ilustrim. Përpjesa nuk është reale

PERSONELI

Momentalisht departamenti i matematikës ka 16 profesorë, 1 ligjërues, 5 asistentë, 2 administratorë të rrjetit kompjuterik dhe 2 zyrtare të shërbimit të studentëve.

Me qëllim të lehtësimit të njohjes dhe komunikimit (sidomos për studentët e ri) në tabelat e mëposhtme janë paraqitur të dhënat e personelit së bashku me fotografitë.

Të dhënat më të detajuara mund të gjenden në ueb-faqen e personelit të FShMN-së:
<https://fshmn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,14>



Prof. Dr.
Ramadan Zejnullahu
Kab. 7
ramadan.zejnullahu@uni-pr.edu



Prof. Dr.
Muhib Lohaj
Kab. 2
muhib.lohaj@uni-pr.edu



Ligjërues
Ramadan Limani
Kab. 2
ramadan.limani@uni-pr.edu



Prof. Ass.
Menderes Gashi
Kab. 5
menderes.gashi@uni-pr.edu



Prof. Dr.
Faton Berisha
Kab. 3
faton.berisha@uni-pr.edu



Prof. Dr.
Naim Braha
Kab. 6
naim.braha@uni-pr.edu



Prof. Asoc.
Bujar Fejzullahu
Kab. 8
bujar.fejzullahu@uni-pr.edu



Prof. Ass.
Elver Bajrami
Kab. 4
Shef i departamentit
elver.bajrami@uni-pr.edu



Prof. Ass.
Edmond Aliaga
Kab. 4
edmond.aliaga@uni-pr.edu



Prof. Ass.
Armend Shabani
Kab. 1
armend.shabani@uni-pr.edu



Prof. Ass.
Kajtaz Bllaca
Kab. 5
kajtaz.bllaca@uni-pr.edu



Prof. Ass.
Behar Baxhaku
Kab. 7
behar.baxhaku@uni-pr.edu



Ass.
Artan Berisha
Kab. 8
artan.berisha@uni-pr.edu



Prof. Asoc.
Qëndrim Gashi
Kab. 3
qendrim.gashi@uni-pr.edu




Prof. Ass.
Eliot Bytyçi
Kab. 6
eliot.bytyci@uni-pr.edu




Prof. Asoc.
Ejup Fejza
Kab. 9
ejup.fejza@uni-pr.edu



Prof. Asoc.
Ermir Rogova
Kab. 1
ermir.rogova@uni-pr.edu



Ass.
Manush Mustafa
Kab. P8
manush.mustafa@uni-pr.edu



Ass.
Korab Rrmoku
Kab. P8
Sekretar i departamentit
korab.rrmoku@uni-pr.edu



Ass.
Astrit Ferizi
Kab. P8
astrit.ferizi@uni-pr.edu



Prof. Ass.
Ujkan Bajra
Kab. 9
ujkan.bajra@uni-pr.edu



Ass.
Albina Kalimashi
Kab. 9
albina.kalimashi@uni-pr.edu



Artan Alidema
Administratror i rrjetit
artan.alidema@uni-pr.edu



Bashkim Trupaj
Administratror i rrjetit
bashkim.trupaj@uni-pr.edu



Nurtene Hasani
Zyrtare për studime baçelor
nurtene.hasani@uni-pr.edu



Shpresa Canolli
Zyrtare për studime master
shpresa.canolli@uni-pr.edu

PROGRAMET E STUDIMIT

Departamenti i matematikës ofron këto lloje të studimeve:

1. Studime themelore – baçellor,
2. Studime master.

Studimet baçellor zgjasin 3 vjet dhe gjenerojnë 180 pikë ECTS-së. Me përfundimin e suksesshëm të studimeve baçellor fitohet thirrja akademike baçellor i shkencës.

Studimet master zgjasin 2 vjet dhe gjenerojnë 120 pikë ECTS-së.

Përfundimi me sukses i studimeve themelore – baçellor është kusht për regjistrimin e studimeve master. Me përfundimin e suksesshëm të studimeve master fitohet thirrja akademike master i shkencës.

Në kohën e publikimit të këtij dokumenti, në departamentin e matematikës zhvillohen këto programe të akredituara të studimit:

- Programet studimore në nivelin Baçellor i shkencës (BSc)
 - Matematikë ,
 - Matematikë financiare në banka dhe sigurime,
 - Shkencë kompjuterike.
- Programet studimore në nivelin Master i shkencës (MSc)
 - Matematikë {vetëm viti i dytë i studimeve}
 - Shkencë kompjuterike {në proces të akreditimit}

BSc Matematikë

SEMESTRI: I				
Nr.	O/Z	Lënda	L	U
1	O	Analiza matematike I	3	3
2	O	Matematika elementare	3	2
3	O	Gjeometri elementare	3	2
4	O	Programimi I	2	2
5	O	Gjuhë angleze	2	0
SEMESTRI: II				
Nr.	O/Z	Lënda	L	U
1	O	Analiza matematike II	3	3
2	O	Algjebra lineare I	3	3
3	O	Gjeometri analitike	3	3
4	O	Programimi II	2	2
SEMESTRI: III				

Nr.	O/Z	Lënda	L	U
1	O	Diferencialet e funksioneve me shumë ndryshore	2	2
2	O	Kombinatorika dhe teoria e grafeve	2	2
3	O	Algjebra lineare II	2	2
4	O	Teoria e gjasës	3	2
5	Z	Metoda optimizimi	2	2
6	Z	Strukturat e të dhënave dhe algoritmet	2	2
7	Z	Pako softuerike për matematikë	2	1
Udhëzim. <i>Studenti duhet të zgjedhë një nga lëndët zgjedhore për semestrin III.</i>				
SEMESTRI: IV				
Nr.	O/Z	Lënda	L	U
1	O	Integralet e funksioneve me shumë ndryshore	2	2
2	O	Teoria e numrave	2	2
3	O	Matematika numerike	3	2
4	O	Gjeometri deskriptive	2	2
5	Z	Hyrje në matematikën aktuale	2	2
6	Z	Bazat e të dhënave	2	2
7	Z	Modelimi matematik	2	2
Udhëzim. <i>Studenti duhet të zgjedhë një nga lëndët zgjedhore për semestrin IV.</i>				
SEMESTRI: V				
Nr.	O/Z	Lënda	L	U
1	O	Strukturat algjebrike	3	2
2	O	Ekuacionet diferenciale të zakonshme	3	2
3	O	Hapësirat metrike	2	2
4	O	Fizika	2	2
5	Z	Procesimi i tekstit në LaTeX	2	2
6	Z	Hapësira euklidiane	2	2
7	Z	Menaxhimi i projekteve	2	1
Udhëzim. <i>Studenti duhet të zgjedhë një nga lëndët zgjedhore për semestrin V.</i>				
SEMESTRI: VI				
Nr.	O/Z	Lënda	L	U
1	O	Analiza komplekse	3	2
2	O	Statistika	3	2
3	O	Hapësirat vektoriale	2	2
4	O	Hyrje në gjeometrinë diferenciale	2	2
5	Z	Transformimet e Laplasit	2	2
6	Z	Kapituj të zgjedhur nga teoria e gjasës dhe statistika	2	2
Udhëzim. <i>Studenti duhet të zgjedhë një nga lëndët zgjedhore për semestrin VI.</i>				

Pas zgjedhjes së lëndës zgjedhore ajo shndërrohet në lëndë obligative dhe studenti nuk do të mund ta ndërrojë lëndën.

BSc Matematikë financiare në banka dhe sigurime

SEMESTRI: I				
Nr.	O/Z	Lënda	L	U
1	O	Analizë I	3	2
2	O	Algjebra I	3	2
3	O	Matematike elementare	2	2
4	O	Matematika diskrete	2	2
5	O	Kontabiliteti financiar	2	1
6	O	Praktikum i kompjuterit	1	3
SEMESTRI: II				
Nr.	O/Z	Lënda	L	U
1	O	Analizë II	3	2
2	O	Algjebra II	2	2
3	O	Mikroekonomia	2	2
4	O	Metodat e optimizimit I	3	3
5	O	Hyrje në programim	2	3
6	O	Gjuhe angleze	2	0
7	Z	Matemat. e aplikuar në biznes dhe ekonomi	2	2
8	Z	Menaxhimi i biznesit të vogël dhe të mesëm	2	2
Udhëzim. <i>Studenti duhet të zgjedhë vetëm njërën nga lëndët zgjedhore për semestrin II.</i>				
SEMESTRI: III				
Nr.	O/Z	Lënda	L	U
1	O	Analizë III	2	2
2	O	Teoria e Gjases I	3	2
3	O	Programimi I	2	3
4	O	Metodat numerike I	2	2
5	O	Makroekonomia	3	2
6	Z	Modelimi matematik	2	2
7	Z	Bazat e të dhënave	2	2
8	Z	Bazat e menaxhmentit	2	2
Udhëzim. <i>Studenti duhet të zgjedhë vetëm njërën nga lëndët zgjedhore për semestrin III.</i>				
SEMESTRI: IV				
Nr.	O/Z	Lënda	L	U
1	O	Analiza IV	2	2
2	O	Matematika financiare	2	2
3	O	Teori e gjasës II	2	2
4	O	Menaxhimi banker	2	2
5	O	Kontabiliteti i Institucioneve financiare	2	2
6	Z	Financat e korporatave	2	2
7	Z	Metodat numerike II	2	2
8	Z	Analiza Financiare	2	2
Udhëzim. <i>Studenti duhet të zgjedhë vetëm njërën nga lëndët zgjedhore për semestrin IV.</i>				
SEMESTRI: V (akreditimi 2016)				

Nr.	O/Z	Lënda	L	U
1	O	Statistika	2	2
2	O	Teoria e lojërave	3	3
3	O	Tregjet dhe institucionet finaciare	2	2
4	O	Proceset stokastike I	2	2
5	Z	Programimi në WEB	2	2
6	Z	Biznesi elektronik	2	2
7	Z	Analiza e algoritmeve	2	2
Udhëzim. <i>Studenti duhet të zgjedhë dy nga lëndët zgjedhore për semestrin V.</i>				
SEMESTRI: VI (akreditimi 2016)				
Nr.	O/Z	Lënda	L	U
1	O	Statistika me zbatim në biznes	2	2
2	O	Menaxhimi i riskut dhe sigurimeve	3	2
3	O	Proceset stokastike II	2	2
4	O	Marketing	2	2
5	O	Auditimi	2	1
6	Z	Financat ndërkombëtare	2	2
7	Z	Metoda optimizimi II	2	2
8	Z	Ekonometria	2	2
Udhëzim. <i>Studenti duhet të zgjedhë dy nga lëndët zgjedhore për semestrin VI.</i>				

Pas zgjedhjes së lëndës zgjedhore ajo shndërrohet në lëndë obligative dhe studenti nuk do të mund ta ndërrojë lëndën.

BSc Shkencë kompjuterike

SEMESTRI: I				
Nr.	O/Z	Lënda	L	U
1	O	Matematikë elementare	2	2
2	O	Matematikë diskrete	2	2
3	O	Programimi dhe algoritmet	2	2
4	O	Hyrje në shkencë kompjuterike	2	2
5	O	Gjuhë angleze I (për shkencë kompjuterike)	2	2
SEMESTRI: II				
Nr.	O/Z	Lënda	L	U
1	O	Kalkulus I	2	2
2	O	Algjebër lineare me gjeometri analitike	2	2
3	O	Strukturat e të dhënave	2	2
4	O	Rrjetat kompjuterike dhe WWW	2	2
5	Z	Algjebër	2	2
6	Z	Aplikacione kompjuterike I	2	2
7	Z	Gjuhë angleze II	2	2
Udhëzim. <i>Studenti duhet të zgjedhë një nga lëndët zgjedhore për semestrin II.</i>				
SEMESTRI: III				
Nr.	O/Z	Lënda	L	U
1	O	Kalkulus II	2	2
2	O	Analiza numerike I	2	2
3	O	Arkitektura e kompjuterit	2	2
4	O	Bazat e të dhënave	2	2
5	Z	Sistemet operative	2	2
6	Z	Programimi për paisje mobile	2	2
7	Z	Matematikë konkrete	2	2
8	Z	Aplikacione kompjuterike II	2	2
Udhëzim. <i>Studenti duhet të zgjedhë një nga lëndët zgjedhore për semestrin III.</i>				
SEMESTRI: IV				
Nr.	O/Z	Lënda	L	U
1	O	Analiza numerike II	2	2
2	O	Teoria e gjasës	2	2
3	O	Programimi OOP dhe GUI	2	2
4	O	Siguria e të dhënave	2	2
5	Z	Ndërtimi i kompilatorit	2	2
6	Z	Teoria e matricave	2	2
7	Z	Inteligjenca artificiale	2	2
8	Z	Programimi linear	2	2
Udhëzim. <i>Studenti duhet të zgjedhë një nga lëndët zgjedhore për semestrin IV.</i>				
SEMESTRI: V (akreditimi 2016)				

Nr.	O/Z	Lënda	L	U
1	O	Programimi në WWW	2	2
2	O	Analizë e algoritmeve	2	2
3	O	Statistikë	2	2
4	Z	Analiza e të dhënave	2	2
5	Z	Kontabiliteti	2	2
6	Z	Modelimi softverik	2	2
7	Z	Teoria e lojërave	2	2
8	Z	Ndërtimi i dokumentacionit teknik	2	2

Udhëzim. *Studenti duhet të zgjedhë dy nga lëndët zgjedhore për semestrin V.*

SEMESTRI: VI (akreditimi 2016)

Nr.	O/Z	Lënda	L	U
1	O	Programimi i distribuar	2	2
2	O	Procesimi i imazheve	2	2
3	O	Inxhinierimi i softuerit	2	2
4	O	Shkrim akademik me kulturë gjuhe	2	2
5	Z	Biznesi dhe interneti	2	2
6	Z	Zhvillimi i softverit në OOP	2	1
7	Z	Programimi paralel	2	2
8	Z	Proceset stohastike	2	2
9	O	Punim Diplome		

Udhëzim. *Studenti duhet të zgjedhë dy nga lëndët zgjedhore për semestrin VI.*

Pas zgjedhjes së lëndës zgjedhore ajo shndërrohet në lëndë obligative dhe studenti nuk do të mund ta ndërrojë lëndën.

MSc Matematikë

SEMESTRI: III				
Nr.	O/Z	Lënda	L	U
1	O	Ekuacionet diferenciale parciale	3	0
2	O	Kap. të zgjedhur nga gjeo. e hap. të Banach-ut	3	0
3	O	Metodologjia e kërkimit shkencor	3	0
4	Z	Matematika për gara të studentëve	0	3
5	Z	Elemente të teorisë spektrale	3	0
6	Z	Teoria analitike e numrave	3	0
7	Z	Teoria e funksioneve harmonike	3	0
Udhëzim. <i>Studenti duhet të zgjedhë dy nga lëndë zgjedhore për semestrin III.</i>				
SEMESTRI: IV				
Nr.	O/Z	Lënda	L	U
1	O	Seminari	3	0
2	O	Punim diplome		

Pas zgjedhjes së lëndës zgjedhore ajo shndërrohet në lëndë obligative dhe studenti nuk do të mund ta ndërrojë lëndën.

MSc Shkencë kompjuterike

SEMESTRI: I				
Nr.	O/Z	Lënda	L	U
1	O	Hyrje në shkencën e të dhënave	2	2
2	O	Kalkulus i avancuar	2	2
3	O	Statistikë e avancuar	2	2
4	O	Metodologjia e hulumtimit shkencor	3	1
5	Z	Inteligjenca artificiale	2	2
6	Z	Programimi funksional	2	2
Udhëzim. <i>Studenti duhet të zgjedhë një lëndë zgjedhore, përveç në rastet kur në studimet BSc nuk ka ndjekur lëndën Inteligjenca artificiale, atëherë kjo bëhet obligative.</i>				
SEMESTRI: II				
Nr.	O/Z	Lënda	L	U
1	O	Seminar	3	1
2	O	Algjebër e avancuar	2	2
3	O	Të mësuarit e makinës	2	2
4	O	Siguria dhe privatësia e informacioneve	2	2
5	Z	Marketingu i gjelbër dhe përgjegjësia sociale	2	2
6	Z	Shkenca kompjuterike dhe shoqëria	3	1
Udhëzim. <i>Studenti duhet të zgjedhë një lëndë zgjedhore për semestrin e dytë.</i>				
SEMESTRI: III				
Nr.	O/Z	Lënda	L	U
1	O	Të dhënat e shumta (big data)	2	2
2	O	Kompjutimi në cloud	2	2
3	O	Ndërmarrësia	2	2
4	Z	Analiza e rrjetave	2	2
5	Z	Kompjutimi me performancë të lartë	2	2
6	Z	Informatat në web	2	2
7	Z	Procesimi i imazheve	2	2
Udhëzim. <i>Studenti duhet të zgjedhë dy lëndë zgjedhore për semestrin e tretë.</i>				
SEMESTRI: IV				
Nr.	O/Z	Lënda	L	U
1	O	Tema e masterit		

Pas zgjedhjes së lëndës zgjedhore ajo shndërrohet në lëndë obligative dhe studentit nuk do të mund ta ndërrojë lëndën.

ORGANIZIMI I STUDIMEVE

PRANIMI NË STUDIME

Secili kandidat që e kalon testin e maturës, gëzon të drejtën për të konkurruar për studime në Universitetin e Prishtinës sipas legjislacionit në fuqi.

Kushtet për pranim në studimet themelore – baçellor në Universitet janë:

1. Përfundimi me sukses i shkollës së mesme në Kosovë i vërtetuar me diplomë,
2. Përfundimi me sukses i shkollës fillore dhe të mesme me së paku 12 vjet të shkollimit vërtetuar me diplomë përkatëse,
3. Përfundimi me sukses i shkollës fillore dhe të mesme me së paku 12 vjet të shkollimit vërtetuar me diplomë përkatëse të fituar në botën e jashtme, në qoftë se është bërë baras-vlerësimi me diplomën e maturës. Vendimi për njohjen e diplomës dhe barasvlerën merret nga Ministria përkatëse.

Senati nxjerr rregullore, të cilat përcaktojnë në hollësi kushtet dhe kriteret për regjistrim në studimet themelore – baçellor dhe ato master.

Studentët në studime Master pranohen mbi bazën e konkurrencës, sipas rezultateve të studimeve paraprake dhe ekuivalencës së tyre, sikurse përcaktohet në Ligjin për Arsimin e Lartë.

Numri i vendeve për studime baçellor dhe master përcaktohet nga Senati për çdo vit të parë të studimit në secilën njësi akademike, me propozimin e këshillit përkatës.

Vendimi bazohet në numrin e përgjithshëm të studentëve që do të shkollohen me shpenzime publike të ofruara nga ana e Ministrisë.

Rregullat për shpalljen e konkursit dhe kriteret për regjistrim nxirren nga Senati.

PROVIMI PRANUES

Në departamentin e matematikës, provimi pranues organizohet në lëndën e matematikës. Në këtë rast studenti duhet të kalojë pragun prej 40% të pikëve në provimin pranues si njëri nga kushtet për regjistrim në vitin e parë të studimeve. Shembuj të pyetjeve të provimit pranues nga vitet e kaluara mund të gjenden në Aneksin A të këtij dokumenti.

Kandidatët të cilët nuk janë pranuar në vitin e parë të studimeve master mund të ankohen kundër vendimit brenda tri ditëve të punës pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjes.

Vendimi përfundimtar rreth ankesës merret nga komisioni 5 anëtarësh, kryesuar nga prorektori për mësim dhe çështje të studentëve dhe me anëtarë të tjerë të emëruar nga rektori.

PËRCAKTIMI I SUKSESIT AKADEMIK

Për përcaktimin e suksesit akademik do të aplikohen këto metoda:

1. Provimi,
2. Kolokiumi,
3. Punimi seminarik,
4. Praktika profesionale,
5. Testi praktik gjatë ushtrimeve,
6. Interpretimi dhe prezantimi i krijimtarisë artistike dhe i punëve të tjera.

Provimet shërbejnë si mënyrë e rregullt e vlerësimit të dijes. Provimet mund të organizohen veç e veç për çdo lëndë ose të kombinohen për më shumë lëndë në pajtim me programin e studimeve (provim me komision).

Provimet janë publike dhe mbahen në këto mënyra:

1. Me shkrim,
2. Me gojë,
3. Me shkrim dhe me gojë,
4. Praktike.

Provimet e kombinuara me gojë dhe me shkrim bëhen brenda shtatë ditëve. Provimet vlerësohen nga një pyetës ose nga një komision për provime. Provimet mund të mbahen nga një komision për provime nëse:

1. Studenti është ankuar,
2. Është caktuar me programin e studimeve.

Procedura e mbajtjes së provimit është e përcaktuar me programin e studimit. Mënyra e përcaktimit të dijes dhe të dhënies së provimit do të përcaktohet me programin mësimor të lëndës – syllabus.

Provimet për studimet baçellor dhe master mbahen gjatë afatit të provimeve. Afatet e provimeve përfshijnë afatin e dimrit (janarit), pranverës (qershorit) dhe vjeshtës (shtatorit).

Periodha e saktë për çdo afat është e përcaktuar me kalendarin e përgjithshëm të studimeve, i cili është i pranuar nga Senati dhe i hapur për publikun. Hollësitë rreth datës së fillimit dhe përfundimit të secilit afat të provimeve përcaktohen nga këshillat e njësive akademike.

Në të gjitha rastet kur studenti mungon ose tërhiqet nga provimi, provimi konsiderohet që ka dështuar (është notuar me 5).

Studenti ka të drejtë të parashtrojë ankesë me shkrim dekanit të njësisë akademike kundër notës së marrë. Ankesa duhet të parashtrohet brenda dy ditëve të punës pasi të jenë shpallur rezultatet.

Ankesa mund të bëhet për këto arsye:

- Për provimin me shkrim – parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me shkrim,
- Për provimin me gojë – parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me gojë,
- Për provimin e kombinuar me shkrim dhe me gojë:
 - Parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me shkrim para hyrjes në provimin me gojë,
 - Parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me gojë që nënkupton se është pranuar nota nga provimi me shkrim.

Studenti ka të drejtë të riprovohet në lëndën të cilën nuk e ka dhënë. Sipas rregullës, studenti ka të drejtë të hyjë më së shumti tri herë në provimin të cilin nuk e ka dhënë.

Studentit pasi të ankohet, me një arsyetim të fortë, mund t'i lejohet nga dekani i njësisë akademike që të hyjë në provim për të katërtën herë. Provimi pastaj mund të mbahet para komisionit prej tre anëtarësh të cilët janë të emëruar nga dekani i njësisë akademike.

Në rast se sërish regjistrohet viti i njëjtë, nuk merret parasysh numri i mëparshëm i provimeve të dështuara të studentit.

Në rast se studentit sërish dështon 4 herë në provim gjatë vitit të përsëritur, ai humb statusin e studentit të rregullt për këtë lloj të studimeve.

Studenti mund të ri ftojë statusin e studentit në qoftë se paraqitet në një program të ri të studimeve.

Pas përfundimit të semestrit të fundit të rregullt të studimeve baçellor dhe master, studentit do t'i caktohet një periudhë prej 12 muajve për t'i përfunduar provimet (periudha e diplomimit).

Studenti mund të kërkojë një herë nga dekani i njësisë akademike për vazhdimin e periudhës së diplomimit edhe për 12 muaj të tjerë.

PËRMBUSHJA E OBLIGIMEVE DHE PARAQITJA E PROVIMEVE

Studenti nuk mund t'u nënshtrohet provimeve në lëndët, përkitazi me të cilat nuk ka përmbushur obligimet në pajtim me programin e studimit.

Studenti nuk mund t'i paraqesë apo t'u nënshtrohet provimeve të vitit akademik, në të cilin i ndjek studimet, para se t'i përfundojë ato të vitit paraprak.

Vijimi i rregullt i procesit mësimor dhe kryerja e obligimeve të tjera, të parapara me programin e studimeve lidhur me lëndën e caktuar, konfirmohet në fund të semestrit në platformën elektronike SEMS.

Konfirmimi mbi kryerjen e obligimeve merret (nëse ndryshe nuk është përcaktuar me programin e studimeve) kur vërtetohet se studenti ka qenë i pranishëm së paku 75% të orëve të ligjëratave dhe të ushtrimeve. Në rastin e ushtrimeve laboratorike nevojitet që studenti të ketë qenë i pranishëm në të gjitha orët e parapara.

PUNIMI I DIPLOMËS

BAÇELLOR

Në programet në të cilat për përfundimin e studimeve kërkohet punimi i temës së diplomës, vlen si më poshtë.

Studenti ka të drejtë ta paraqesë kërkesën për nisjen e procedurave për punimin e diplomës baçelor, pasi të ketë regjistruar semestrin e fundit në kuadër të programit të studimeve dhe me kusht që t'i ketë përfunduar të gjitha provimet e semestrit paraprak.

Pasi të konsultohet me profesorin për punimin e diplomës së baçellorit, studenti merr kërkesën (formulari F1B) me numër protokolli në arkivin e njësisë akademike dhe ia dorëzon sekretarit të njësisë akademike.

Mentor mund të jetë mësimdhënësi nga personeli akademik i cili është së paku Dr. Sc.

Në mbledhjen e departamentit aprovohet kërkesa për temë, caktohet mentori dhe komisioni për mbrojtje.

Punimi i diplomës së baçellorit duhet të jetë i shkruar qartë, në pajtim me normat e shkrimit akademik, me një terminologji të përpunuar dhe me redaktim e teknikë të nevojshme dhe sipas udhëzuesit të UP-së.

Punimin e diplomës baçelor, studenti e dorëzon në kopje fizike (të protokolluar) dhe në formë elektronike, së paku shtatë (7) ditë para mbrojtjes publike.

Data e mbrojtjes caktohet jo më herët se pesë (5) ditë kalendrike nga data e përfundimit të provimit të fundit dhe njoftimi publikohet në uebfaqen e njësisë akademike.

Prej datës kur aprovohet kërkesa për punimin e diplomës së baçellorit dhe caktohet mentori, deri në datën e mbrojtjes publike, duhet të kalojë së paku një muaj, por jo më shumë se një vit kalendrik.

Punimin e diplomës së baçellorit, studenti e dorëzon në një kopje fizike të protokolluar dhe në formë elektronike (CD) së paku 7 ditë para mbrojtjes.

Studenti ka të drejtë vetëm një herë të paraqesë kërkesë me dëshmi për vazhdimin e afatit për mbrojtjen e punimit të diplomës. Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet pëlqimi me shkrim i mentorit se tema është aktuale dhe dëshmia përkatëse për arsyet e vonesave që kanë pamundësuar përfundimin e temës me kohë. Dekani i njësisë akademike shqyrton kërkesën për shtyrje të afatit të mbrojtjes publike të diplomës.

MASTER

Studenti mund të parashtrojë kërkesë për miratimin e propozimit të tezave përkatësisht projekt propozimin e punimit të diplomës master pasi të ketë përfunduar të gjitha obligimet e parapara nga programi i studimit, respektivisht për studentet e programeve të studimeve me 120 ECTS të kenë të përfunduar të gjitha provimet e semestrave të vitit të parë të studimeve.

Forma e kërkesës për miratim të tezave - projekt propozim të diplomës merret në zyrat për shërbime të studenteve ose në ueb faqe të fakultetit. (F1)

Kërkesa e kompletuar dhe e nënshkruar nga mësimdhënësi i cili mund të jetë kandidat potencial për mentor, protokollohet dhe i dorëzohet shërbimit.

Mentor i punimit të diplomës mund të jetë secili mësimdhënësi i cili e ka njërën nga thirrjet profesor në UP. Në rast nevojë, mentor mund të jetë edhe mësimdhënësi me njërën nga thirrjet profesor jashtë UP-së, mirëpo me këtë rast duhet të propozohet edhe një bashkë-mentor (ko-mentor) brenda UP-së.

Punimi i diplomës master është individual dhe mund të punohet edhe nga grup kërkimor prej 2 apo 3 studentëve.

Departamenti shqyrton kërkesën e studentit lidhur me propozimin për projektin e diplomës master dhe i propozon këshillit të fakultetit për miratim. Në rast të miratimit, departamenti e propozon edhe komisionin për vlerësim të punimit të diplomës.

Të paktën tre muaj pas datës së vendimit të këshillit të fakultetit për aprovim të kërkesës për vlerësim të projekt propozimit dhe në bashkëpunim me mentorin, kandidati mund të paraqesë kërkesë për vlerësim të dorëshkrimit, kërkesa (F2).

Kërkesa e protokolluar bashkë me katër kopje të buta të punimit të diplomës dorëzohet në shërbim.

Në mbledhjen e radhës të departamentit, komisioni paraqet raportin për vlerësim të dorëshkrimit të punimit të diplomës (F3).

Në rast se departamenti miraton raportin e komisionit, ai i propozon këshillit të fakultetit për miratim komisionin për mbrojtje publike. Anëtarët e komisionit për mbrojtje publike duhet të jenë së paku dy veta nga fushat e ngushta të punimit të diplomës nga Fakulteti përkatës.

Në rast se kandidati nuk e përfundon punimin e diplomës më së largu 1 (një) vit nga data kur është lejuar tema nga Këshilli i Fakultetit, kandidati mund të paraqesë kërkesë për vazhdimin e punimit të temës në periudhën shtesë prej 6 muajsh, pas të cilës kohë konsiderohet se punimi nuk është rezultuar i suksesshëm dhe kandidati obligohet të paraqesë temën e re të diplomës me mentor të ri.

VITI AKADEMIK

Universiteti organizon studimet në pajtim me programet ekzistuese të studimit gjatë vitit akademik i cili zgjatë 12 muaj. Viti akademik fillon më 1 tetor dhe mbaron më 30 shtator.

Periodha aktive e studimeve (ligjëratat, ushtrimet, seminarët, kolokuiumet) është e ndarë në dy semestra. Semestri dimëror që fillon më 1 tetor dhe mbaron më 15 janar. Semestri veror që fillon më 16 shkurt dhe mbaron më 31 maj.

Lënda mund të ligjërohet me javë (15 javë semestri) gjatë një apo dy semestrave ose mund të mbahet si bllok ligjëratash në një semestër.

Kalendari i studimeve nxirret nga Senati më së voni deri më 31 maj dhe përmban orarin e ligjëratave (ligjëratat, ushtrimet, seminarët, kolokuiumet), kushtet dhe afatet e provimit.

NDËRRIMI I DREJTIMIT TË STUDIMEVE

Studenti mund të bëjë ndërrimin e programit të studimit duke përfunduar mësimin në një program të studimit dhe duke filluar mësimin në një program tjetër të studimit në njësinë e njëjtë apo në njësinë tjetër akademike të Universitetit.

Ndërrimi i programit të studimit është i mundur në mes programeve të studimit me qëllim të arritjes së nivelit të njëjtë të arsimit në pajtim me statutin e UP-së.

Gjatë ndërrimit të programit të studimit studentit i lejohet legalisht të fillojë programin e ri të studimit nëse së paku 50% e provimeve janë dhënë me sukses gjatë programit të vjetër të studimeve dhe që pranohen në programin e ri të studimeve. Studentit i lejohet të regjistrohet në programin e ri të studimeve:

- Më së paku në vitin e dytë të studimeve ose,
- Më së mirë në vitin e studimeve që vijon pas programit të vjetër të studimeve.

Ndërrimi i programit të studimit nuk mund të bëhet nëse studentit duhet sërish të regjistrohet në vitin e parë të studimeve në programin e ri të studimeve.

Në nivelin MSc, për ndërrimin e programit të studimit ose për transferimin e studentit prej ndonjë Fakulteti tjetër të UP-së, ose prej ndonjë Universiteti tjetër të akredituar brenda a jashtë vendit, vlejné dispozitat e parapara me Statutin e Universitetit të Prishtinës.

BIBLIOGRAFIA

1. [Statuti i universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”](#)
2. [Rregullore për studime themelore – baçellor](#)
3. [Rregullore për studime Master shkencor](#)
4. [Rregullore për plotësim-ndryshim të rregullores nr. 2-922, dt. 24.10.2019, për studimet master](#)

